



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.05.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR SUBVENCIONIMIN E FAMILJEVE PËR REGJISTRIM TË FËMIJËVE
NË INSTITUCIONE PARASHKOLLORE PRIVATE

1. Miratohet Subvencionimi i familjeve në vlerë prej 70 euro për regjistrim të fëmijëve në institucione parashkollore private.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, subvencionimi do të vlejë vetëm për familjet të cilat kanë të ardhura më pak se pesëqind (500) euro në muaj.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, subvencionimi për regjistrim të fëmijëve në institucione parashkollore private, vlen vetëm për IP-të e licencuara, sipas shtojcës e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Subvencionimi i familjeve do të bëhet në bazë të Thirrjes publike, ku përzgjedhjen në bazë të kriterëve do ta bëjë një komision i themeluar nga Kryetari i Kryeqytetit. Subvencionimi do të jetë në vlerë prej 100,000.00 euro në vit nga Kategoria e subvencioneve e Drejtorisë së Arsimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtorja e Arsimit dhe Drejtorja e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-107166/23, më 29.05.2023

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina

